

UDHËZIM
Nr. 8, datë 21.1.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015,
“PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË
PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË
RREGULLUAR TË MËSUESIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 3 të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Shkronja “I” e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

“I) Nënshkrimin elektronik të Drejtorit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe vulën elektronike të QSHA-së”.

b) Pika 8 ndryshon si më poshtë:

“8. Kandidati i suksesshëm në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, aplikon nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” për pajisjen me licencën për ushtrimin e profesionit. QSHA-ja brenda 45 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit pajis aplikuesin me licencë. Licenca dërgohet si dokument me vulë elektronike, në llogarinë e tij në portalin unik qeveritar “e-Albania”.”

c) Pikat 9 dhe 11 shfuqizohen.

d) Pas pikës 14, shtohet pika 14/1 me përmbajtje si më poshtë:

“14/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucionet përgjegjëse, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare/zyrat vendore arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani